




REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK



Nr. Prot.

Vlorë, më 04.09.2017

Vendim
Nr. 85, datë 04.09.2017

PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË
DYTË TË STUDIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018

Mbështetur në nenin 76 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 04.09.2017

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve të pranimit në programet e licensuara të ciklit të dytë të studimit për vitin akademik 2017-2018 si vijon:
 - a) Miratimin e kriterëve të përcaktuara nga njësitë bazë të Fakultetit të Ekonomisë për pranimin e kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve për vitin akademik 2017-2018 si më poshtë:

Programet e studimit "Master profesional"

- a. Në programin e studimit "*Master profesional* në marketing":

- Do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e studimit të programit përkatës.
- Kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotëron.

- b. Në programin e studimit "*Master profesional* në sipërmarrje në turizëm":

- Do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi. Përparësi do të



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e studimit të programit përkatës.

- Kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotëron.

c. Në programin e studimit "*Master profesional në administrim publik*":

- Do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e studimit të programit përkatës.
- Kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotëron.

d. Në programin e studimit "*Master profesional në financë*":

- Do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor".
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e studimit Financë, Kontabilitet, Aktuaristikë, Matematikë, Financë, të cilët do të renditen sipas mesatares dhe në vazhdim studentët që zotërojnë një diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë e pas tyre studentët që vijnë nga programe të tjera studimi.

e. Në programin e studimit "*Master profesional në kontabilitet*":

- Do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor".
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e studimit Financë, Kontabilitet, Aktuaristikë, Matematikë, Financë, të cilët do të renditen sipas mesatares dhe në vazhdim studentët që zotërojnë një diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë e pas tyre studentët që vijnë nga programe të tjera studimi.

f. Në programin e studimit "*Master profesional në ekonomiksi në sipërmarrje*":



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- Do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë “Bachelor” në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi.
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë një diplomë “Bachelor në Ekonomiks” nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, më pas ata që zotërojnë një diplomë “Bachelor” në fushën e ekonomisë nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, renditur sipas mesatares.
- Më tej, kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e studimit të programit përkatës ose të përafërt, do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotëron.

Programet e studimit "Master i shkencave"

a. Në programin e studimit “*Master i shkencave* në administrim-biznes”:


- Do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë “Bachelor në ekonomi”, apo dhe fusha të tjera studimi. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e ekonomisë.
- Kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotëron.

b. Në programin e studimit “*Master i shkencave* në financë”:

- Do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë “Bachelor”.
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e studimit Financë, Kontabilitet, Aktuaristikë, Matematikë, Financë, të cilët do të renditen sipas mesatares dhe në vazhdim studentët që zotërojnë një diplomë “Bachelor” në fushën e ekonomisë e pas tyre studentët që vijnë nga programe të tjera studimi.

c. Në programin e studimit “*Master i shkencave* në pasuri të paluajtshme”:

- Do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë “Bachelor”.
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e studimit Financë, Kontabilitet, Aktuaristikë, Matematikë, Financë, Arkitekturë, Inxhinieri Ndërtimi, të cilët do të renditen sipas mesatares dhe



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

në vazhdim studentët që zotërojnë një diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë e pas tyre studentët që vijnë nga programe të tjera studimi.


d. Në programin e studimit "*Master i shkencave në ekonomiks*":

- Do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi.
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë një diplomë "Bachelor në Ekonomiks" nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, më pas ata që zotërojnë një diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, renditur sipas mesatares.
- Më tej, kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e studimit të programit përkatës ose të përafërt, do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotëron.

b) Miratimin e kriterëve të përcaktuara nga njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Humane për pranimin e kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve për vitin akademik 2017-2018 si më poshtë:

1. Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë të studimeve "*Master Profesional* në ciklin fillor me profil minor ne ciklin parashkollor" në Departamentin e Edukimit kandidatët që:

- Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë "Bachelor në mësuesi për arsimin fillor" dhe "Bachelor në mësuesi për arsimin parashkollor".
- Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në drejtimin disiplinor Mësuesi për Arsimin Fillor dhe Mësuesi për Arsimin Parashkollor dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
- Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare, deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
- Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë të studimeve "*Master profesional*" në mësuesi për arsimin e mesëm në lëndët Histori Gjeografi" në Departamentin e Edukimit kandidatët që:

- Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë "Bachelor në Histori Gjeografi.ose programe te ndara
- Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në drejtimin disiplinar Mësuesi për Histori Gjeografi dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
- Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare, deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
- Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.

3. Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë të studimeve "*Master i shkencave*" në Edukim" në Departamentin e Edukimit, kandidatët që:


- Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë në disipinat e mësimdhënies.
- Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në drejtimin disiplinar në mësimdhënie dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
- Nota minimale mesatare e kandidatit në studimet "Bachelor" është 6 (gjashtë).
- Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare, deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
- Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.

4. Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë të studimeve "*Master i shkencave*" në pedagogjinë e specializuar sociale" në Departamentin e Edukimit, kandidatët që:



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë në Pedagogjinë e specializuar, Shkencat sociale, Mjekësi, Shëndet publik.
 - Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në drejtimin disiplinor disiplinat pedagogjisë së specializuar dhe shkencat sociale dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
 - Nota minimale mesatare e kandidatit në studimet "Bachelor" është 6 (gjashtë).
 - Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare, deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
 - Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.
5. Kanë të drejtë të aplikojnë në programin e ciklit të dytë të studimeve "*Master i shkencave* në përkthim-interpretim" në Departamentin e Gjuhëve të Huaja, kandidatët që:
- Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë "Bachelor" në gjuhë të huaj.
 - Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në gjuhë të huaj dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
 - Nota minimale mesatare e kandidatit në studimet "Bachelor" është 6 (gjashtë).
 - Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
 - Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.
6. Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë të studimeve "*Master profesional* në mësimdhënie për CLAB", gjuhë angleze dhe gjuhë italiane, në Departamentin e Gjuhëve të Huaja, kandidatët që:



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë "Bachelor" në gjuhë të huaj.
 - Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në gjuhë të huaj dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
 - Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
 - Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.
7. Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë të studimeve "*Master i shkencave* në marrëdhënie ndërkombëtare" dhe "*Master profesional* në drejtë penale" dhe në "Shkenca administrative" në Departamentin e Drejtësisë, kandidatët që:
- Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë "Bachelor në Drejtësi".
 - Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në drejtësi dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
 - Kanë notën mesatare minimale në studimet "Bachelor": 6 (gjashtë), vetëm për aplikantët në programet e studimit "Master i shkencave".
 - Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare, deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
 - Preferohen kandidatët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.
8. Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë të studimeve "*Master i shkencave* në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe letërsisë" në Departamentin e Gjuhë-Letërsisë, kandidatët që:
- Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi".
 - Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

drejtimin disiplinuar gjuhë shqipe dhe letërsi dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.

- Nota minimale mesatare e kandidatit në studimet "Bachelor" është 6 (gjashtë).
- Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare, deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
- Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.

3. Miratimin e kriterëve të përcaktuara nga njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Teknike për pranimin e kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve për vitin akademik 2017-2018 si më poshtë:

Për programet e studimit "Master profesional":


Për të gjithë kandidatët që plotësojnë detyrimet e Udhëzimit nr. 18, dt. 16.08.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 15, datë 19.06.2017 Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, programet e studimit me karakter profesional, si edhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2017-2018", kreu VI/4:

1. Përzgjedhja e studentëve të bëhet bazuar në kriterin e notës mesatare duke i vendosur në rendin zbritës deri në plotësimin e kuotave të miratuara për diplomën përkatëse.

Kritere preferenciale

- Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në IAL-publike dhe pastaj atyre që vijnë nga IAL jopublike.
- Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në programet e studimit pranë FSHT-së, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.
- Jepet përparësi studentëve që kanë ngjashmëri të diplomës së ciklit të parë të studimeve me diplomën e ciklit të dytë për të cilën aplikojnë.

Për programet e studimit "Master i shkencave":



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Për të gjithë kandidatët që plotësojnë detyrimet e Udhëzimit nr. 18, dt. 16.08.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 15, datë 19.06.2017 Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, programet e studimit me karakter profesional, si edhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2017-2018", kreu VI/4:

1. Përzgjedhja e studentëve të bëhet bazuar në kriterin e notës mesatare të ponderuar duke i vendosur në rendin zbritës deri në plotësimin e kuotave të miratuara për diplomën përkatëse.


Kritere preferenciale

- Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në IAL-publike dhe pastaj atyre që vijnë nga IAL jopublike.
 - Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në programet e studimit pranë FSHT-së, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.
 - Jepet përparësi studentëve që kanë ngjashmëri të diplomës së ciklit të parë të studimeve me diplomën e ciklit të dytë për të cilën aplikojnë.
4. Miratimin e kriterëve të përcaktuara nga njësitë bazë të Fakultetit të Shëndetit Publik për pranimin e kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve për vitin akademik 2017-2018 si më poshtë:

Për "Master profesional në infermieri patologjike dhe kirurgjikale":

1. Të pranohen kandidatët që zotërojnë diplomat e mëposhtme:

- Diplomë "Bachelor në infermieri të përgjithshme"
- Diplomë "Bachelor në mami infermier"
- Diplomë "Bachelor në infermieri në shëndet publik"
- Diplomë "Bachelor në teknik laborator"
- Diplomë "Bachelor në fizioterapi"
- Diplomë "Bachelor në teknik radiolog"
- Diplomë "Bachelor në higjenist dentar"
- Diplomë të sistemit të vjetër: "Infermier i përgjithshëm"



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

të fituara në përfundim të ciklit të parë të studimeve në të gjitha fakultetet apo shkollat e larta të infermierisë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Përzgjedhja e kandidatëve në programet e studimit "Master profesional" do të bëhet në bazë të rendit zbritës të mesatares së ponderuar të notave të tyre në ciklin e parë të studimeve. Nëse do të ketë studentë me të njëjtën mesatare në studimet "Bachelor" në fund të listës, renditjen do ta përcaktojë rendi zbritës i mesatares së Maturës Shtetërore.

3. Politika përzgjedhëse e kandidatëve të jetë si më poshtë:

- Studentët që kanë kryer studimet në UV.
- Studentët që kanë kryer studimet në Institucione Publike të Arsimit të Lartë.
- Studentët që kanë kryer studime në Institucione Private të Arsimit të Lartë.

Për "Master i shkencave në shkenca infermierore" të pranohen kandidatët që:

1. Zotërojnë diplomat e mëposhtme:

- Diplomë "Bachelor në infermieri të përgjithshme"
- Diplomë "Bachelor në mami infermier"
- Diplomë "Bachelor në infermieri në shëndet publik"
- Diplomë "Bachelor në teknik laborator"
- Diplomë "Bachelor në fizioterapi"
- Diplomë "Bachelor në teknik radiolog"
- Diplomë "Bachelor në higjenist dentar"
- Diplomë të sistemit të vjetër: "Infermier i përgjithshëm"

të fituara në përfundim të ciklit të parë të studimeve në të gjitha fakultetet apo shkollat e larta të infermierisë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Përzgjedhja e kandidatëve në programet e studimit "Master i shkencave" do të bëhet në bazë të rendit zbritës të mesatares së ponderuar të notave të



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

tyre në ciklin e parë të studimeve. Mesatarja e ponderuar e notave të diplomës së marrë në ciklin e parë të studimeve duhet të jetë ≥ 7.5 .

3. Politika përzgjedhëse e kandidatëve të jetë si më poshtë:

- Studentët që kanë kryer studimet në UV.
- Studentët që kanë kryer studimet në Institucione Publike të Arsimit të Lartë.
- Studentët që kanë kryer studime në Institucione Private të Arsimit të Lartë.

Për "Master profesional në infermieri pediatrike":

1. Të pranohen kandidatët që zotërojnë diplomat e mëposhtme:

- Diplomë "Bachelor në infermieri të përgjithshme"
- Diplomë "Bachelor në mami infermier"
- Diplomë "Bachelor në infermieri në shëndet publik"
- Diplomë "Bachelor në teknik laborator"
- Diplomë "Bachelor në fizioterapi"
- Diplomë "Bachelor në teknik radiolog"
- Diplomë "Bachelor në higjenist dentar"
- Diplomë të sistemit të vjetër: "Infermier i përgjithshëm"

të fituara në përfundim të ciklit të parë të studimeve në të gjitha fakultetet apo shkollat e larta të infermierisë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Përzgjedhja e kandidatëve në programet e studimit "Master profesional" do të bëhet në bazë të rendit zbritës të mesatares së ponderuar të notave të tyre në ciklin e parë të studimeve. Nëse do të ketë studentë me të njëjtën mesatare në studimet "Bachelor" në fund të listës, renditjen do ta përcaktojë rendi zbritës i mesatares së Maturës Shtetërore.

3. Politika përzgjedhëse e kandidatëve të jetë si më poshtë:

- Studentët që kanë kryer studimet në UV.
- Studentët që kanë kryer studimet në Institucione Publike të Arsimit të Lartë.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- Studentët që kanë kryer studime në Institucione Private të Arsimit të Lartë.
2. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI



Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.